



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:022761

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05776737

C.nr. 76/2024

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.B nga fshati Ofterushë, Komuna e Rahovecit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati A.M nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike për kompensimi i ushqimit në pune dhe kompensim të shpenzimeve të udhëtimit, vlera e objektit të kontestit 326.00 euro, jashtë seancës, më datën 04.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRSI SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit I.B.
- II. DETYROHET paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.B, në emër të kompensimit për shpenzimet e udhëtimit për periudhën kohore prej datës 01.10.2021 e deri më datën 03.03.2022 për 96, ditë pune për vajtje dhe ardhje nga shtëpia në punë dhe anasjelltas sipas çmimit të biletës për dy relacionet në shumën prej 2.00 euro dhe atë për 70% të këtij çmimi të ja paguajë shumën prej 1.40, tia paguaj shumën prej 134.00 euro, po ashtu në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 01.10.2021 e deri më datën 03.03.2022 për 96 ditë pune të ja paguajë shumën prej 192.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, apo shumën e përgjithshme prej 326.00 euro, me kamatë ligjore 8% nga data 19.01.2024 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm”.
- III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit I.B, t’i paguajë shumën prej 98,00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi I.B, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 19.01.2024, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për

kompensim të shpenzimeve të udhëtimit në punë dhe kompensimit të ushqimit, vlera e kontestit 326.00 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se ka punuar si mësimdhënës në SHLMP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, e që për periudhën e kërkuar paditësit nga data 01.10.2021 e deri me datën 03.03.2022 i ka takuar e drejta e kompensimit për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit sipas Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës të datës 21.01.2021, por që deri më tani nuk është kompensuar. Periudha e kërkuar sipas padisë është nga data 01.10.2021 e deri më 03.03.2022 dhe atë për paditësin I.B për 96 ditë të prezencës në punë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 10.05.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Ndërkaq kërkesat që dalin nga kontestet e marrëdhënies së punës fillimisht duhet të parashtrihen tek punëdhënësi. Gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësit i kanë shtjerrur të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Në këtë rast paditësi nuk ka parashtruar kërkesë për kompensim pranë të paditurës. Me rastin e lidhjes së kontratave kolektive në nenin 2 të dy kontratave janë deleguar kompetenca dhe detyrime për të paditurën pa u shoqëruar edhe me buxhet shtesë, këto detyrime nuk janë zbatuar nga niveli qendror i pushtetit. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditësit pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për faktin se komunat kanë kompetenca vetanake, të zgjeruara dhe të deleguara në pajtim me ligjin, autoriteti shtetëror që delegon kompetencat, përballon shpenzimet për ushqimin e delegimit. E njëjta ka theksuar se sipas aktgjykimit C.nr.127/2020, me numër të lëndës 2020:059229, paditësi është kompensuar për ushqim dhe udhëtim, për periudhën kohore nga 18.04.2017-20.09.2021. Po ashtu i ka kontestuar vërtetimet e shoqatave të transportit. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave, për paditësin I.B: vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 03/422 i datës 11.12.2023, i lëshuar nga IAAP“Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit të muajit janar 2024, të lëshuar nga “L në Prizren për paditësin I.B, vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës me Nr. të protokollit 097, e datës 11.03.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit dhe udhëtimit si dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e vërtetimin e çmimit të biletës së udhëtimit i muajit janar 2024, i lëshuar nga “L në Prizren për paditësin I.B, gjykata vërtetoi faktin se çmimi i biletës së udhëtimit në relacionin Operushë – Rahovec si dhe anasjelltas është 2 euro në dy drejtime.

Me administrimin e vërtetimin mbi ditët e prezencës në punë me Nr. 03/422 i datës 11.12.2023, i lëshuar nga IAAP“Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, gjykata vërtetoi faktin se paditësi I.B, në periudhën kohore prej datës 01.10.2021 e deri më 31.12.2021 ka prezantuar në punë në 60 ditët e punës, ndërsa prej datës 01.01.2022 e deri më 03.03.2022 ka prezantuar në punë në 36 ditët e punës, gjithsej për këteë periudhë 96 ditë pune.

Me administrimin e Vendimit për përfundimin e mardhënies së punës me Nr. të protokollit 097 e datës 11.03.2022, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit I.B, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ka pasur kontratë pune me të paditurën dhe i njëjti ishte i sistemuar në vendin dhe me detyrat e punës në SHMLP “Selajdin Mullaabazi - Mici” në Rahovec, i cili e përfundoi mardhënien e punës me datë 03.03.2022, për shkak të moshës së pensionimit.

Provave të lartcekura gjykata iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 paragrafi 1 të LPK-së, i cili përcakton se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësi I.B në periudhën kohore nga data 01.10.2021 e deri më 31.12.2022, në vendin tij të punës kanë prezantuar 60 ditë të punës ndërsa prej datës 01.01.2022 e deri më 03.03.2022 ka prezantuar në punë në 36 ditët e punës, gjithsej për këteë periudhë 96 ditë pune.

Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që “*Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore*” Për paditësin I.B në rast se shumëzohen 96 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro do të kemi shumën e përgjithshme prej 192 euro.

Kjo është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se “*Marrëveshja*

Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”.

Ndërkaq sipas nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*. Në rast se shumëzohen 96 ditët e prezencës në punë me 70% të shumës prej 2 euro për çdo biletë (70% i 2 euro = 1.40 euro) do të kemi shumën e përgjithshme prej 134.00 euro.

Sa i përket legjitimitetit real pasiv të palës së paditur, gjykata vlerëson se pala e paditur ka legjitimitet që të jetë e paditur në këtë çështje kontestimore për faktin se sipas nenit 2 par.1 pika 1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, dispozitat e kësaj kontrate kolektive të arsimit janë të obligueshme për të gjithë punëdhënësit e sektorit të arsimit në Kosovë, përfshirë edhe komunat dhe drejtoritë komunale të arsimit.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e të paditurës se paditësi është kompensuar për ushqim dhe udhëtim, me numër C.nr.127/2020 me numër të lëndës 2020:059229, por ka vërtetuar se paditësi është kompensuar për periudhën 18.04.2017 deri më 20.09.2021, ndërsa padia që është duke u trajtuar është për periudhën 01.10.2021, e deri me datën 03.03.2022, pra kemi të bëjmë me periudha të ndryshme kohore, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palës së paditur, por nuk ishin relevante në zgjidhjen e kësaj çështje kontestimore.

Vendimin lidhur me kumatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.1 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësja t’ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi,

në shumën e përgjithshme prej 98,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 78.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 20.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.76/2024, më datën 04.06.2024

B.Profesionale
Shpresa Haxhijaha Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.